



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
PATENTAVE DHE MARKAVE

Nr. 339 Prot, datë 18.11.2010

MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
DOGANAVE

Nr. 16345 Prot, datë 18.11.2010

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PËR

SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT NË KUADËR TË MBROJTJES SË PRONËSISË INDUSTRIALE

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (në vijim DPPM) nën varësinë e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Z. Safet SULA, Drejtor i Përgjithshëm

dhe

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (në vijim DPD) nën varësinë e Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Z. Flamur GJYMISHKA, Drejtor i Përgjithshëm,

Në zbatim të Ligjit Nr. 9947, datë 7.7.2008 “Për Pronësinë Industriale”, Ligjit Nr. 8449, datë 27.1.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 11 e në vijim, VKM Nr. 205, datë 13.4.1999, “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar, palët e mësipërme bien dakord për nënshkrimin e kësaj Marrëveshje bashkëpunimi si më poshtë vijon:

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ka për qëllim shkëmbimin e informacionit midis DPPM dhe DPD, për të mundësuar rritjen e nivelit të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale, intensifikimin e bashkëpunimit institucional dhe dhënies së asistencës teknike të ndërsjellë për këtë qëllim.

Neni 2

Mënyra e bashkëveprimit

1. DPPM dhe DPD marrin përsipër të caktojnë pika kontakti të përhershme. Njoftimi mbi pikën e kontaktit bëhet me shkrim në rrugë zyrtare.
2. Kërkesa për informacion lidhur me të dhëna apo elementë të caktuar mbi pronësisë industriale bëhet nga DPD, përmes pikës së kontaktit, në rrugë elektronike (përmes e-mail) si dhe pasohet nga shkresa zyrtare. Pika e kontaktit në DPPM, është përgjegjës për dhënien e informacionit të kërkuar nga DPD lidhur me të dhëna të pronësisë industriale që disponohen nga DPPM, pa vonesë, në rrugë elektronike (e-mail) dhe të pasuar me shkresë zyrtare.

Neni 3

Detyrimet e palëve

Për përmbushjen e qëllimit të këtij memorandumi, palët angazhohen si më poshtë:

1. DPPM si institucion që regjistron dhe administron regjistrat e objekteve të pronësisë industriale (patentat, modelet e përdorimit, markat tregtare dhe të shërbimit, disenjot industriale, treguesit gjeografikë), me qëllim mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale, vë në dispozicion të plotë të DPD, informacionin e nevojshëm për fillimin ose vazhdimin e procedurave të parashikuara nga legjislacioni doganor, kundrejt kërkesës nga DPD dhe sipas mënyrave të parashikuara nga kjo marrëveshje.
2. DPD merr përsipër ruajtjen e konfidencialitetit ndaj informacionit të siguruar sipas kësaj marrëveshjeje si dhe mund ta përdorë këtë informacion vetëm në kuadër dhe për qëllime të zbatimit të legjislacionit në fuqi për këtë qëllim.
3. Informacionet të cilat do të konsiderohen të padisponueshme në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe ligjeve kombëtare, nuk do të jenë pjesë e kësaj marrëveshje bashkëpunimi.
4. DPPM dhe DPD marrin përsipër të ofrojnë asistencë teknike të ndërsjellë në rastet e hartimit të akteve ligjore apo nënligjore në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale.

5. DPPM dhe DPD marrin përsipër të ofrojnë trajnime duke përfshirë në mënyrë të ndërsjellë personelin teknik në aktivitete trajnimi në fushën e pronësisë industriale të organizuara nga secili institucion.

Neni 4

Hyrja në fuqi, vlefshmëria, ndryshimet etj.

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga përfaqësuesit e Palëve.
2. Marrëveshja është e vlefshme derisa palët të mos kenë kërkuar shfuqizimin e saj.
3. Marrëveshja hartohet dhe pranohet nga palët, duke nënkuptuar se asnjë dispozitë e saj nuk është në tejkalim ose kundërshtim të akteve përkatëse ligjore e nënligjore, mbi të cilat palët ushtrojnë veprimtarinë e tyre.
4. Palët, kur gjykohet e arsyeshme dhe duke rënë dakord paraprakisht midis tyre, mund të ndryshojnë ose shtojnë dispozita të kësaj Marrëveshje.
5. Marrëveshja e Bashkëpunimit përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje; 2 (dy) për Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave dhe 2 (dy) për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

PËR

**DREJTORINË E PËRGJITHSHME
TË PATENTAVE DHE MARKAVE**

Safet SULA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

PËR

**DREJTORINË E PËRGJITHSHME
TË DOGANAVE**

Flamur GJYMISHKA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM